



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 11 të Ligjit për Mbrojtje nga diskriminimi Nr.05/L-021 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR CAKTIMIN E ZYRTARES PËRGJEGJËSE PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI NË
KOMUNËN E LIPJANIT

I. Me këtë Vendim, **Fjolla Ibrahim**, Zyrtare në Qendrën për Punë Sociale në Lipjan, **CAKTOHET**, Zyrtare përgjegjëse për mbrojtje nga diskriminimi në Komunën e Lipjanit.


II. E lartëcekura do ti kryej detyrat si Zyrtare për mbrojtje nga diskriminimi si detyrë shtesë në kudër të detyrave të punës konform dispozitave ligjore që rregullojnë fushën e mbrojtjave të drejtave të njeriut në koordinim dhe bashkëpunim me institucionet e nivelit qëndror e posaqërisht me Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZQM).

III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi 1Nr.112-61448 për caktimin e zyrtares përgjegjëse për mbrojtje nga diskriminimi i datës 13.11.2017.

Vendimi idërgohet:
Zyrtares së lartëcekur
Në shkresat e lëndës

1Nr. 112/02-58445
Lipjan, më 11.10.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenit 23 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATAVE TË KLUBEVE SPORTIVE PARALIMPIKE PËRFITUESE TË SUBVENCIONEVE PËR VITIN 2023

Neni 1

Me këtë Vendim, **Ramiz Gashi**, Zyrtar në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratave të klubeve sportive paralimprike përfituese të subvencioneve për vitin 2023.

Zyrtari përgjegjës do të bëjë monitorimin e zbatimit të kontratave të klubeve sportive paralimprike si vijon :

Nr.	Emërtimi i OJQ-ve (klubet sportive paralimprike)
1.	Klubi ParaPingPong PAK "LIPJANI"
2.	Klubi Paravolejbollit PAK "LIPJANI"
3.	KPBO PAK "Blinaja"

Neni 2

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontratave të klubeve të cekura konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, obligohet zyrtari përgjegjës që të kërkon nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport paisen me nga një kopje të kontratave të cekura në nenin 1.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Ramiz Gashi zyrtar përgjegjës dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

1Nr. 112/02-60922
Lipjan, më 25.10.2023



KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIM E RREGULLORES PËR ORARIN E PUNËS SË
VEPRIMTARIVE EKONOMIKE NË KOMUNËN E LIPJANIT NR.15-330/02-22376 TË
DATËS 28.04.2023

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Projekt-Rregullores për orarin e punës së veprimtarive ekonomike Nr.15-330/02-22376 të datës 28.04.2023. në Komunën e Lipjanit, në këtë përbërje:

- 1.Valon Pacolli, Drejtor në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim, Kryesues
- 2.Rexhep Rexhepi,Drejtor në Drejtoratin për Bujqësi
3. Vlora Krasniqi, Shefe në Sektorin për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore, anëtare
4. Enis Gashi, Inspektor në Drejtoratin për Inspeksion, anëtar
5. Bedri Hetemi , Inspektor në Drejtoratin për Inspeksion, anëtar
6. Fitore Buja, Zyrtare në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtare dhe
- 7.Shqipe Rexhepi ,Zyrtare në Drejtoratin per Inspeksion, anëtare

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi të hartoj ndryshimin dhe plotësimin e Projekt-Rregullores për orarin e punës së veprimtarive ekonomike në Komunën e Lipjanit, konform dispozitave përkatëse ligjore në fuqi më së largu deri me 27.10.2023.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëtin do të njoftohen kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 1-020/04-58977
Lipjan, më 12.10.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 19/2015 për kushtet dhe procedurat e ndërrimit të emrit personal si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR NDËRRIMIN
DHE KORIGJIMIN E EMRIT PERSONAL

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për ndërrimin dhe korrigjimin e emrit personal në përbërje si vijon:

1. Fauz Xhemajli, Shef i Sektorit të Gjendjës Civile, kryesues
2. Mirlinda Azemi, Zyrtare e Gjendjës Civile, anëtare
3. Ardian Metaj, Zyrtar i Gjendjës Civile, anëtar.

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit

1. Komisioni ka detyrë dhe përgjegjësi të shqyrtoj kërkesat e palëve dhe të vendos për ndërrimin e emrit personal konform procedurave të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-118 për emrin personal si dhe Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr.19/2015 për kushtet dhe procedurat e ndërrimit dhe korrigjimit të emrit personal si dhe akteve tjera ligjore përkatëse në fuqi.
2. Komisioni për punën e vet mbanë procesverbal.
3. Pas miratimit nga Komisioni, vendimet i nënshkruan kryesuesi i Komisionit.

Neni 3
Hyrja në fuqi

1. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin njoftohet kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi 1Nr.112/02-40903 i datës 02.08.2022.

1Nr. 020/1-60827
Lipjan, 25.10.2023



KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, nenit 7 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15.Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE TË
STUDENTËVE PËR NDARJEN E BURSIVE

Neni 1
Përbërja

Formohet, Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve të studentëve për ndarjen e bursave të cilët kanë aplikuar sipas Konkursit publik të shpalluar nga Drejtorati për Arsime me Nr.4-670/01-55807 i datës 29.09.2023, në përbërje si vijon:

1. Ismet Haziri, Drejtorati për Arsime, Kryesues
2. Ibrahim Duriqi, Drejtorati për Arsime, anëtar
3. Shahadije Ibrahim, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka për detyrë që të shqyrtoj aplikacionet e studentëve për ndarjen e bursave brenda afatit 15 ditësh nga dita e mbylljes së konkursit publik, konform kriterëve të përcaktuara me dispozitat e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15.Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022, Rregullores për ndryshimin e Rregullores për ndarjen e bursave për student të Komunës së Lipjanit Nr.15-670/01-22599 të datës 28.04.2023 dhe kriterëve të përcaktuara në Konkursin publik të shpalluar nga Drejtorati për Arsime me Nr.4-670/01-55807 të datës 29.09.2023.
2. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve, Komisioni shpallë listën preliminare në faqen zyrtare të Komunës ndërsa pas përfundimit të procedurave të ankesave Komisioni vlerësues shpallë listën përfundimtare të përfituesve.
3. Punët administrative- teknike për Komisionin do të kryej Drejtorati për Arsime.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit me kopjen e të cilit do të njoftohen DKA-ja, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-56652
Lipjan, më 03.10.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve (Festivali i Fëmijëve) në Komunën e Lipjanit që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-52274 të datës 13.09.2023, në përbërje si vijon:

1. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Laureta Ahmeti, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Blerta Bytyqi nga OJQ, në cilësinë e ekspertes anëtare
5. Florim Budakova, nga shoqëria civile, anëtar
6. Saranda Krasniqi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare rezervë

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve (festivalit të fëmijëve) në Komunën e Lipjanit konform Thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-52274 të datës 13.09.2023, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 01-453/01-58/85
Lipjan, më 10.10.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për Transparencë në Komuna, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM
MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR PROJEKT-RREGULLOREN PËR ORARIN E
PUNËS TË VEPRIMTARIVE EKONOMIKE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË
LIPJANIT

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Projekt-Rregullore për Orarin e Punës të Veprimtarive Ekonomike në Territorin e Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Projekt-Rregullore mund ti dërgohen Komisionit punues për hartimin e Projekt - Rregullores për Orarin e Punës të Veprimtarive Ekonomike në Territorin e Komunës së Lipjanit në email adresën valon.pacolli@rks-gov.net më së largu me datë 13.10.2023.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës.

1Nr. 01-011/01-59157
Lipjan, më 13.10.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Na osnovu članova 13, 58 i 68 stav 68.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.03/L-040, Službena Novina Republike Kosova, br.28 dt. 4 juni 2008, članova 40, 41 i 67 Statuta Opštine Lipljan 15Br.110-78095 dt. 24.12.2021, Administrativno Uputstva (MUP) br.03/2020 za Transparentnost u Opštinama, Administrativno Uputstvo (MUP) br.06/2018 o minimalnim standardima javnih konsultacija u opštinama, Uredba o Transparentnosti u Opštini Lipljan Br. 15-353-35739, dt.30.06.2021, Predsednik Opštine donosi:

ODLUKA
O JAVNOJ KONSULTACIJI ZA PROJEKT-UREDBA ZA RADNO VREME
EKONOMSKIH DELATNOSTI NA TERITORIJI OPŠTINE LIPLJAN

Član 1

U cilju sprovođenja konsultacija i učešća javnosti, u usvajanju akata iz nadležnosti Opštine, objaviti na Websajt Opštine:

Projekt-Uredba za Radno Vreme Ekonomskih Delatnosti na Teritoriji Lipljan.

Član 2

Primedbe i sugestije na ovaj Projekt –Uredbu mogu se poslati Radnoj Komisiji za izradu Projekt –Uredba o Radnom Vremenu Ekonomskih Delatnosti na Teritoriji Lipljan na email adresu: valon.pacolli@rks-gov.net naj kasnije do 13.11.2023.

Član 3

Ova Odluka stupa na snagu danom usvajanja i biće objavljena na Websajt Opštine.

1Br. 01-011/01-59157
Lipljan, 13.10.2023

PREDESDNIK OPŠTINE

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në Vendimin përfundimtar të komisionit vlerësues për shpalljen e përfituesve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të (klubet sportive paralimpik) Nr.5-453/01-55239 të datës 26.09.2023, Rekomandimit të Komisionit vlerësues Nr.1-400/01-55964 të datës 29.09.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR OJQ - TË (KLUBET SPORTIVE PARALIMPIK) PËR VITIN 2023

Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **4,500.00 €** (katërmijë e pesëqind euro), për t'i mbështetur financiarisht OJQ-të (klubet sportive paralimpik) të Komunës së Lipjanit për zhvillimin e aktiviteteve të tyre për vitin 2023, të cilët kanë aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-341785 të datës 09.08.2023, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sportë.

2. Në tabelën vijuese janë OJQ-të (klubeve sportive paralimpik) përfituese të cilat do të mbështeten financiarisht nga Komuna për vitin 2023:

Nr.	Emërtimi i OJQ-ve (klubet sportive paralimpik)	Shuma
1.	Klubi ParaPingPong PAK "LIPJANI"	1,500.00 €
2.	Klubi Paravolejbollit PAK "LIPJANI"	1,500.00 €
3.	KPBO PAK "Blinaja"	1,500.00 €
	Shuma Totale	4,500.00 €

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2023 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe klubeve sportive do të rregullohen në Kontratat të cilat do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe secilit klub veq e veq.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr.400/01-55964
Lipjan, më 02.10.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **7,000.00€**, (shtatë mijë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-56474 e datës 03.10.2023, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 25 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin shtator të vitit 2023 me nga 280 euro për secilin rast $25 \times 280 = 7,000.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2023, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryeatrit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-56474
Lipjan, më 04.10.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

VENDIM PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES

Neni 1 Përbërja

Me këtë Vendim themelohet grupi punues për hartimin e Planit të Veprimit për personat me aftësi të kufizuar në Komunën e Lipjanit 2024 - 2026, në përbërje si vijon:

1. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës së Lipjanit, Kryesues
2. Shkelzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar
3. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit për Arsim, anëtar
4. Hasan Luma, Zyrtar në Drejtoratin për Administratë, anëtar
5. Makfirete Shamolli, Drejtoreshë e QPS-së, anëtare
6. Milazim Miftari, Shef në Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari, anëtar
7. Pranvera Krasniqi, Zyrtare në Drejtoratin për Kultur, Rini dhe Sport, anëtare
8. Rafete Retkoceri, Zyrtare në Drejtoratin për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtare
9. Mirjeta Cakolli-Bajqinca, Doktoresh në QKMF-ja Lipjan, anëtare
10. Jetmir Bytyqi, Zyrtar në Drejtoratin për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar
11. Shqipe Rexhepi, Zyrtare në Drejtoratin për Inspektorat, anëtare
12. Valdete Muji, Zyrtare Ligjore në Zyren e Kryetarit të Komunës, anëtare
13. Laureta Ahmeti, Zyrtare në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, anëtare
14. Fatlum Breznica, Zyrtar në Drejtoratin për Prokurim, anëtar
15. Merita Zeqiri-Magashi, Zyrtare në Drejtoratin për Infrastrukturë, anëtare
16. Shkelqesa Miftari, Zyrtare në Drejtoratin për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtare
17. Feime Selmani, Zyrtare në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtare
18. Vlora Shabani, Psikologe dhe asistente e fëmijëve me nevoja të veçanta në SHFMU "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan,
19. Afrim Mena, Shoqata HANDIKOS dega në Lipjan, anëtar dhe
20. Fadil Behluli, Shoqata OMPAK dega në Lipjan, anëtar

Neni 2 Detyrat e grupit punues

Grupi punues ka për detyrë hartimin Planit të Veprimit për personat me aftësi të kufizuar në Komunën e Lipjanit 2024 - 2026 në bashkëpunim me shoqatat lokale Handikos dhe Ompakal që veprojnë në Lipjan, hartimi i planit nga grupi punues do të bëhet konformë dispozitave përkatëse ligjore në fuqi. Punët teknike administrative për grupin punues do të kryhen nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Neni 3 Hryja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Grupit punues.

INr. 1-020/02-60155
Lipjan, më 20.10.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

